



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1267/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Nebojsa Vlajic – Kandidat për Anëtar të Kuvendit Komunal nga subjekti politik GI SDP Oliver Ivanovic dega në Zvecan, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të pa rregullsive, gjatë procesit të votimit, të Zgjedhjeve Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 10.12.2013, morri këtë:

VENDIM

Hidhet si e pa afatshme ankesa e Nebojsa Vlajic – Kandidat për Anëtar të Kuvendit Komunal nga subjekti politik GI SDP Oliver Ivanovic dega në Zvecan.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 06.12.2013 në ora 13:30 nga parashtruesi i ankesës Nebojsa Vlajic – Kandidat për Anëtar të Kuvendit Komunal ku ka pretenduar se, në fshatrat Srbovac, Grabovac, pra në qendrat e votimit në QV 2914B, 1215B nga publikimi zyrtar i rezultateve përfundimtare, numërimi i votave të cilat i kanë fituar individualisht kandidatët tonë për asamble nuk korrespondojnë me gjendjen reale dhe nuk përputhen me numërin e votave të fituara nga kandidatët. Më tutje ka shtuar se, nga numërimi i votave individuale të kandidatëve në QV 2914B, 1215B nuk janë marrë parasysh fare, sepse kandidatët të cilët i kanë fituar më shumë vota sa janë fituar nga llogaritja përfundimtare e të gjitha VV. Për më tepër ka theksuar se, të dhënat nga fitimi i votave individuale për kandidatët tonë, të cilat i ka publikuar KQZ-ja ndryshojnë shumë nga rezultatet të cilat i ka subjekti politik, pasi që disa nga gjashtë persona nga lista e publikuar e që kanë fituar më së shumti vota në zgjedhjet e tanishme iu është zvogëlu padrejtë numëri i votave, disa nga gjashtë persona nga lista e publikuar e që kanë fituar më së shumti vota në zgjedhjet e tanishme iu është rritur padrejtë numëri i votave, disa nga kandidatët që nuk gjenden në listën e kandidatëve të përzgjedhur nuk kanë fituar mandat edhe pse realisht nuk e kanë fituar këtë rezultat.

Parashtruesi i ankesës ka theksuar se nga veprimet e bëra është shkelur parimi themelor i zgjedhjeve, nenet 101, 8.2, 8.3 i LZP-së. Bazuar në rezultatin zgjedhor, parashtruesi i ankesës ka kërkuar që të përsëritet numërimi i të gjitha votave në të gjitha vendvotimet në komunën e Zvecanit si dhe në qendrat e votimit QV 2914B, 2915B, në mënyrë që të vërtetohen rezultatet individuale për 17 kandidatët tonë nga Iniciativa Qytetare.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmërinë e ankesës gjeti se:

ankesa është e pa afatshme

Me ankesën e parashtruar nga Nebojsa Vlajic – Kandidat për Anëtar të Kuvendit Komunal pretendohet se në QV 2914B, 1215B kanë ndodhur pa rregullsi të shumta si dhe shkelje të LZP-së me rastin e numërimit të votave për kandidat për Asamble Komunale.

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se ankesa e Nebojsa Vlajic – Kandidat për Anëtar të Kuvendit Komunal është e pa afatshme sepse afati ligjor sipas LZP-së është 24 orë nga momenti i shpalljes së vendimit nga KQZ-së e që nënkupton se ky afat ka qenë deri me dt.03.12.2013 në ora 16:30, ndërsa pala ankuese ankesën e ka parashtruar në PZAP me datë 06.12.2013 ora 13:30 nga kjo del se ankesa në fjalë është parashtruar tri ditë pas afatit të paraparë ligjor. Prandaj duke u bazuar në nenin 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1267/2013 më datën 10.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.